



**Republika e Kosovës – Republika Kosova – Republic of Kosova
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK- MUNICIPALITY JUNIK**

Kryesuesi i Kuvendit

Nr. 001/32

Datë: 30.11.2010

Bazuar ne nenit 17 paragrafi r) dhe s) të Ligjit për Vetëqeverisjen e Lokale Nr. 03/L-40, nenit 2.24 të Ligjit për Trashëgiminë Kulturore Nr.02/L-88, nenit 20.1 pika d). E Statutit të Komunës Junik, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me 29.10.2010, merr këtë:

V E N D I M

(Mbi themelimin e muzeut Komunal të Junikut)

I. Me këtë vendim themelohet Muzeu i qytezës së Junikut i cili do të shërbej për ruajtjen, përkujdesjen dhe ekspozimin e eksponateve të trashëgimisë Kulturore, historike, etnografike dhe tradicionale të territorit të Komunës së Junikut.

II. Komuna e Junikut me një vendim të veçantë do të përcaktoj lokacionin për ndërtimin e objektit të Muzeut Komunal.

Arsyetim

Juniku me rrethin është trevë me pasuri të begatshme kulturore etnografike, historike të cilat pasuri janë një thesar i çmuar, me të cilat karakterizohet identiteti i Junikut me rrethin.

Juniku neper histori ka qene një vend i rëndësishëm i lëvizjeve politike nacionale për lirin dhe prosperitetin e kombit shqiptar. Prandaj me qellim të përkujdesjes, grumbullimit ruajtjes dhe ekspozimit të këtij thesari të çmuar ndërtimi dhe funksionalizimi i muzeut të Junikut ka një rendësi të veçantë, ne ruajtjen dhe kultivimin e vlerave të kultivuara nder shekuj.

Ky vendim hyn ne fuqi ditën e aprovimit nga Kuvendi i Komunës dhe i njëjti do te implementohet ne momentin e pare te mundshëm nga ana e ekzekutivit te Komunës.

Me këtë Vendim njoftohen:

- Drejtoria për Administratë të përgjithshme
- Arkiva

Kryesuesi i Kuvendit
z.Sinan Gacaferi